



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 32/2015

Prishtinë, më 6.10.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa - kryetar, Sasha Milosavleviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Duda Balje - anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Pal Lekaj dhe Enver Hoti - anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Zef Dedaj- MTI; Lumnie Murati-ZPRK; Mentor Thaçi -UP; Dardan Abazi dhe Visar Berisha – INDEP; Visar Rushiti dhe Blend Hyseni- GAP; Lejla Selimi – OSBE; Fjolla Uka dhe Genc Jaha- KDI; Kushtrim Ahmeti- KTV; Pranvera Musa- Kosova Press dhe Albulena Mavaraj- Epoka e Re.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 28.9.2015;
3. Shqyrtimi i konkluzioneve lidhur me pozitën aktuale të prodhuesve dhe përpunuesve në industrinë e qumështit;
4. Çështjet vijuese dhe me prioritet në Planin e punës së Komisionit;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, fillimisht shprehu keqardhje që opozita po e bojkoton mbledhjen e Komisionit, sepse ne do të donim që edhe opozita të jetë e pranishme për një mbledhje të tillë tematike që i kushtohet një sektori tejet të rëndësishëm të ekonomisë për çka kanë qenë të interesuar edhe ata, dhe, sigurisht në këtë çështje, do të gjenim një gjuhë të përbashkët. Por, për fat të keq, nëse bojkotohet puna dhe pikat e përbashkëta me interes për qytetarët, do të mbesim jo aq efektivë dhe i ftoi që t'i bashkohen punës së Komisionit.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.9.2015

Kryetari, tha se në mbledhjen e fundit e kishim për miratim edhe procesverbalin e mbledhjes së datës 15.9.2015, mirëpo për shkak se ajo mbledhje ishte tematike, nuk e kam propozuar për miratim, andaj kërkoj që nëse ndonjë deputet ka vërejtje në të dy procesverbalet, le t'i thotë sot ose le t'i dërgojë te shërbimi i Komisionit me shkrim.

Deputetët u deklaruan me votë se nuk kanë vërejtje në procesverbalet e datës 15 dhe 28 shtator 2015, ku njëzëri i miratuan.

3. Shqyrtimi i konkluzioneve lidhur me pozitën aktuale të prodhuesve dhe përpunuesve në industrinë e qumështit

Kryetari, tha se sa i përket pikës së rendit të ditës, që ka të bëjë me pozitën aktuale të prodhuesve dhe përpunuesve në industrinë e qumështit nga mbledhja e kaluar e Komisionit, u zhvillua debat në bazë të dy analizave, njëra e përgatitur nga eksperti i angazhuar nga Komisioni, profesor dr. Mentor Thaçi: “Sfidat dhe problemet e industrisë së qumështit në Kosovë” dhe tjetra e përgatitur nga organizata “INDEP”, që po e mbështet punën e Komisionit: “Tregu i prodhimeve të qumështit dhe mundësitë e Kosovës për zhvillim”. Në vijim, kryetari tha se kishim debat të gjithanshëm nga të gjitha palët e ftuara, dhe mbi bazë të analizave të ekspertëve, Komisioni ftoi në mbledhje të përbashkët përfaqesuesit e prodhuesve, përpunuesve, ministrive përkatëse, AUV-së dhe aktorë të tjerë të interesuar. Sektori i prodhimit dhe i produkteve të qumështit është me rëndësi strategjike, për shkak të potencialve të tij dhe ndikimeve zinxhirore në tërë prodhimin bujqësor. Vlerësohet se ka rreth 20 miniferma që shesin qumështin e tyre dhe rreth 36 qumështore të licencuara. Gjithashtu, vlerësohet se ky sektor ka rreth 20.000 të punësuar, ndërsa në mënyrë indirekte punësimi vlerësohet se është më i madh, deri në 40.000. Ky sektor ka pasur një rritje viteve të fundit dhe një zëvendësim të konsiderueshëm të importit, në krahasim me gjendjen në vitet e herëshme 2000. Megjithatë, në bazë të debatit gjithëpërfshirës në Komision, u pa se ky sektor, përkundër rritjes së tij, viteve të fundit përballët me probleme të ndauarduarshme, duke filluar nga statistikatat, aftësia e tij konkurruese dhe politikat mbrojtëse që do të ishin të natyrshme për një industri të re, siç është ajo e qumështit në Kosovë. Debatit dhe raportet e përgatitura paraprakisht nga ekspertë e organizata të pavarura, provuan se në këtë sektor duhet rregulluar shumëçka, deri te çështjet më bazike, siç janë përshtetshmëritë të dhënave se sa i përmbush nevojat prodhimi vendor me qumësht dhe produkte të qumështit. Sipas të dhënave nga MBZHR-ja, kjo shifër është diku 80%. Kjo u kontestua nga pjesëmarrës tjerë

dhe shoqatat që vlerësonin 50-60%. Vetëm kjo mospërputhje tregon për një situatë brengosëse, sepse politikat që duhet të marrë një shtet lidhur me një sektor, dallojnë shumë kur nevojat vendore përmbushen 50% apo 80%. Gjithashtu, u pa se prodhuesit vendorë, si një sektor i ri, kanë problem me aftësinë konkurruese dhe e neglizhojnë atë dhe të gjitha problemet i shohim jashtë vetes. Mirëpo, ata nuk e kanë edhe mbrojtjen e duhur të konkurrencës fer, nuk kanë mbrojtje nga produktet e ndryshme që shiten me çmime dumping, nuk kanë një mbrojtje sezonale ose me taksa nga produktet me origjinë bimore që shiten si substitute, madje edhe me tiketa jokorrekte. Kosova ka disa sektorë të rinj industrialë premtues, ku mund të ndërtojë aftësi konkurruese dhe duhet të gjejë instrumente që t'i mbrojnë nga konkurrenca jofer dhe të rrisin aftësinë e tyre konkurruese. Kjo është në frymën e tregut të lirë dhe masave të lejueshme nga CEFTA dhe OBT-ja. Problem në vete janë importuesit e këtyre produkteve që shpeshherë gjejnë më shumë

“mirëkuptim” sesa prodhuesit vendorë në emër “të tregut të lirë”. Mbledhja e Komisionit ofroi mjaft të dhëna që të aprovohen rekomandimet e duhura në Kuvend, për ta zhvilluar këtë sektor, në interes të prodhuesve e përpunuesve të këtij sektori, po gjithsesi edhe të konsumatorëve. Përndryshe, sektori i prodhimit dhe i përpunimit të qumështit ka një rëndësi strategjike për zhvillimin e shumë sektorëve tjerë në bujqësi dhe blegtori, andaj është koha që të marrë vëmendjen e duhur. Në debat u pa se kemi probleme të plasimit, të cilat burojnë nga dy arsye: një është aftësia ende e pamjaftueshme e konkurrencës së kësaj industrie, dhe dy, tregu i çrregulluar si mungesë e kapaciteteve institucionale dhe angazhimit të duhur që të zbatohet ligji, të zbatohet mbrojtja dhe të zbatohet konkurrenca fer. Në këtë drejtim, duhet të shihet se çka duhet të bëjë Qeveria dhe çka vetë përpunuesit e qumështit. Së pari, Qeveria duhet ta rrisë aftësinë konkurruese dhe duhet ta mbrojë konkurrencën fer, sepse është e qartë se paraqiten probleme në këtë sferë. Në qoftë se problemet janë sezonale, duhet të zgjidhen me masa mbrojtëse sezonale. Një mbrojtje të lehtë, nuk e ndalon as CEFTA-n dhe askënd, që tre muaj të mbrojnë prodhimin vendor, në mënyrë që të mos dëmtohen prodhuesit. Lidhur me çështjen e yndyrës bimore, duhet shqyrtuar nevojën e futjes së një akcize, ngjashëm me vendet fqinje. Po ashtu, u tha se duhet t'i disiplinohet distributorët dhe shitësit, sepse ata në vend që të tregojnë se është me yndyrë bimore, e vendosin emërtimin djathë ose kaçkavall sepse ai është tregtar dhe ka supermarket dhe se interesi i tij është shitja e tyre, andaj këtu është i nevojshëm angazhimi i inspeksionit. Nevojitet një analizë e efektivitetit të subvencioneve, pasi që përkundër tyre, prodhimi i qumështit dhe numri i gjedhëve qumështorë ngelin pak a shumë të njëjta ose zvogëlohen në tri- katër vitet e fundit. Gjithashtu, edhe çështja e prokurimit publik, duhet të rishqyrtohet, që përparësi të kenë ofertat me prodhime vendore. Me politikat e deritanishme të prokurimit, shpesh më shumë përfitojnë importuesit vendorë, sesa prodhuesit vendorë. Po ashtu, edhe çështja e kontratave mes prodhuesve dhe përpunuesve, u tha se duhet të rregullohet dhe të mbrohet zbatimi i tyre korrekt. Në fund, i prezantoi rekomandimet e nxjerra nga dy analizat dhe debati i zhvilluar me të gjitha palët në mbledhjen e datës 28.9.2015 si vijon:

1. Rekomandohet që MTI-ja të marrë masat e nevojshme për një mbrojtje sezonale të qumështit dhe të produkteve të qumështit, në periudhën 1 prill – 31 korrik, duke vënë një prelevman (taksë fikse sezonale), e cila do të siguronte një konkurrencë të barabartë midis industrisë së vendit dhe prodhimeve nga importi.
2. Rekomandohet që Qeveria e Kosovës, përkatësisht ministritë përkatëse, që për një kohë të vendosin një akcizë në importin e produkteve të qumështit me yndyrë nga origjina bimore. AUV-ja duhet të forcojë kontrollin përkatës ligjor të importit,

- ndërsa inspektorët e tregut ekspozimin e tyre korrekt, të ndarë në vende të posaçme dhe jo në vende të përziera me produkte të qumështit.
3. Asociacionet e biznesit dhe të konsumatorëve, në bashkëpunim me mediat, të zhvillojnë fushatë vetëdijësimi për përparësitë e konsumit të qumështit të freskët, në krahasim me atë UHT apo të pasterizuar.
 4. Rekomandohet që të sigurohen informata përkatëse, lidhur çmimin importues, përkatësisht me bazën e doganimit të prokteve të qumështit, si dhe të evitohet importi i produkteve para skadimit të afatit të përdorimit. Gjithashtu, prodhuesit vendorë dhe asociacionet e tyre duhet të prezantojnë me kohë dokumentacionin dhe provat kur konsiderojnë se ka raste të dumpingut në çmime nga importuesit.
 5. MTI-ja dhe MBZHR-ja, duhet të sigurojnë statistikën e sakta mbi prodhimin vendor dhe importin e qumështit dhe produkteve të qumështit.
 6. I rekomandohet Qeverisë, përkatësisht MBZHR-së, që të bëjë një vlerësim lidhur me efektet e politikave të subvencionit të qumështit, me qëllim të arritjes së efekteve më të mëdha.
 7. Të analizohen kushtet higjienike të shtitje së qumështit në tregun e gjelbër dhe të stimulohet ndërlidhja e këtyre prodhuesve të vogël me industrinë e qumështit.
 8. Rekomandohet që asociacionet e biznesit në këtë sektor, në bashkëpunim me MBZHR-në, MTI-në dhe faktorë të tjerë, të hartojnë dhe zbatojnë një program masash për rritjen e aftësisë konkurruese të këtij sektori, për përmirësimin e cilësisë së produkteve, avancimin e marketingut dhe dizajnit të produkteve të këtij sektori.
 9. Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, do të përcjellë zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe do të informojë Kuvendin në një periudhë 6 (gjashtë) mujore mbi aktivitetet dhe rezultatet e zbatimit të tyre.

Besim Beqaj, tha se i ka analizuar me kujdes të gjitha këto rekomandime. Pjesa substanciale është e mirë dhe është në kuadër të aktiviteteve që Kuvendi duhet të merret me këtë çështje. Po ashtu, theksoi se i ka dy shqetësime sa i përket rekomandimeve të cilat mund të shkojnë drejt debilancit me interesin e konsumatorëve. Kjo ka të bëjë me taksën fikse sezonale, sepse parimisht taksa fikse sezonale është në kundërshtim me interesat e mirëqenies së qytetarëve në raport me interesin e konsumatorëve. Çdo taksë që vihet, duhet pasur parasysh elementet që vihet. Ne duhet që këto çështje t'i trajtojmë edhe një herë dhe do të jem i përmbytur në votimin e këtij rekomandimi. Kjo është një kërkesë e Shoqatës së Prodhuesve të Qumështit, po ka edhe mekanizma tjerë për të rritur masat mbrojtëse, për t'i mbrojtur prodhuesit e qumështit. Këtu është ligji për masat antidamping, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë i mbron, prandaj ligji mund të ketë efekt të drejtpërdrejtë dhe ligji del në lëvizje. Për rekomandimin numër 2, ku flitet për akcizë për produktet me yndyrë bimore, duhet ta kemi parasysh që me ligjet që janë aktualisht, duhet ta fuqizojmë inspektoratin që nuk do të lejojë që të keqpërdoren këto produkte dhe ta monitorojë në mënyrë të plotë, dhe, për këtë nuk jam në favor të akcizës, sepse kur vihet akciza, nuk vihet në mënyrë të njëanshme, por duhet të vihet për të gjitha produktet me orgjinë bimore. Ne duhet të kemi parasysh vetëm ato produkte me origjinë bimore që janë të pashëndetshme, sepse sipas standardeve ndërkombëtare, jo të gjitha janë të pashëndetshme dhe nuk janë të pastandardizuar që lejohen në bazë të standardeve. Ai, në fund, tha se ka hezitim në dy rekomandimet e para, sepse realisht, megjithë vullnetin e mirë për t'i përkrahur prodhuesit e industrisë së qumështit dhe konkurrencën e lirë, ne po dëmtojmë konsumatorin final, sepse po iu bëjmë kufizime. Ajo që ne duhet të bëjmë me këto dy raste, është që ligji antidamping të funksionojë në tërësi dhe të kërkojmë përgjegjësi nga ministritë dhe agjencitë përkatëse për t'i zbatuar ligjet për cilësinë e produkteve të cilat shiten në treg.

Fatmir Rexhepi, tha se Komisioni ka bërë një punë të mirë, i cili është marrë në mënyrë aktive që nga paraqitja e kësaj problematike. Lidhur me këtë, një grup i deputetëve ka vizituar edhe Shoqatën e Prodhuesve të Qumështit, për t'u njoftuar me në detaje për problemet që po hasin në treg. Po ashtu, tha se në parim është për rekomandimet, por që rekomandimet nr.1 dhe nr.2, duhet të sqarohen. Ai kërkoi që të kemi një pasqyrë nga ekspertit për masat sezonale që ndërmarrin vendet e rajonit. Po ashtu, tha se duhet t'i miratojmë këto rekomandime dhe t'i dërgojmë në Kuvend, ndërsa Qeveria të marrë masat e duhura.

Raif Qela, propozoi të fillohet kërkesa për nismën e plotësim-ndryshimit të Ligjit për prokurimin publik dhe në ligj të specifikohet se duhet t'u jepet përparësi produkteve vendore. Po ashtu, lidhur me kërkesën e qumsharëve për heqjen e doganës dhe taksave tjera për repromaterial, kërkoi që të merren masa për lirim nga këto taksa.

Blrim Grainca, tha se për rekomandimin nr.6, lidhur me vlerësimin e politikave të subvencionimit, duhet të vlerësohen efektet e subvencionimit për prodhuesit dhe përpunuesit e qumështit. Për politikën e importit, ai tha se çmimet janë 50% më të lira se prodhimet vendore dhe propozoi që për këtë duhet të shtohet edhe një rekomandim që të kërkohet kontroll më i përkushtuar nga Dogana dhe AUV-i, se si po hyjnë këto produkte me këtë çmim shumë më të lirë sesa prodhimet vendore.

Duda Balje, për rekomandimin nr. 4, kërkoi që të riformulohet dhe të marrin informata të sakta lidhur me çmimin importues nga Dogana e Kosovës për produktet e qumështit që importohen para skadimit të afatit të përdorimit.

Kryetari, sa i përket rekomandimit nr. 1 dhe 2, me rëndësi është që janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren nga institucionet përkatëse, siç janë ministrinë dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, që janë të obliguar, në bazë të ligjeve, t'i mbrojnë prodhimet vendore. Ndërsa, sa i përket konkurrencës së lirë, Kosova është përcaktuar për një konkurrencë të lirë dhe fer, mirëpo për shkak që kemi të bëjmë me një industri të re të prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit, ne si institucione duhet t'ju krijojmë kushte për të zhvilluar një konkurrencë të lirë dhe fer, prandaj në këtë drejtim, po i mbrojmë. Për rekomandimin nr.1, tha se masat prej 3 muajve, pra nga 1 prill deri 31 korrik, është masë që merret kur kemi sasi më të madhe të qumështit, dhe për këtë periudhë, blegtorët janë ankuar që nuk po mund ta shesin qumështin, prandaj këtu po kemi problem në mes prodhuesve dhe përpunuesve. Për rekomandimin nr. 2, lidhur me akcizën, ne kemi diskutuar që të merren disa masa të lehta ndaj importuesve të produkteve të qumështit me yndyrë nga origjina bimore. Ai, në fund, tha se në qoftë se i stimulojmë prodhuesit e qumështit, do të kemi rritje në shumë sektorë të tjerë të prodhimit dhe rritje të vendeve të punës.

Blerim Grainca, po ndodh që rekomandimet bëhen, por po ngecin në zbatimin të tyre. Kërkoi që të fuqizohet mbikëqyrja e zbatimit të rekomandimeve, të kemi një metodologji më të mirë për mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve.

Kryetari, tha se çështja e mbikëqyrjes së zbatimit të rekomandimeve është në përcaktuar në rekomandimin nr.9, ku Komisioni ynë do t'i raportojë Kuvendit pas gjashtë muajsh, lidhur me zbatimin e tyre.

Raif Qela, për rekomandimin nr.4, lidhur më çmimin importues, sidomos të produkteve me afat të vogël të skadimit, kërkoi që të rregullohet me ligj dhe të vendosen taksa në import për produktet të cilave i ka mbetur më pak se gjysma e afatit të skadimit, dhe në këtë mënyrë, mund të mbrohet prodhimi vendor nga çmimet shumë të lira të produkteve të importuara në përfundim të afatit të skadimit.

Kryetari, tha se po pajtohem që rekomandimi nr. 4 të riformulohet, që kjo çështje të rregullohet me udhëzim administrativ apo me dispozita ligjore. Në bazë të këtij debati, ne po vijmë në përfundim se duhet të ketë disa korrigjime dhe riformulime të vogla në disa prej rekomandimeve, duke përfshirë në rekomandime çështjen e afatit të skadimit të produkteve të importuara dhe ndryshimin e Ligjit të prokurimit.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këto

Rekomandime

1. Rekomandohet që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë të marrë masat e nevojshme për një mbrojtje sezonale të qumështit dhe produkteve të qumështit, në periudhën 1 prill – 31 korrik / 1 maj - 15 gusht, duke vënë një prelevman (taksë fikse sezonale), e cila do të siguronte një konkurrencë të barabartë midis industrisë së vendit dhe prodhimeve nga importi.
2. Rekomandohet që Qeveria e Kosovës, përkatësisht ministrinë përkatëse, që për një kohë të vendosin një akcizë në importin e produkteve të qumështit me yndyrë nga origjina bimore. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës duhet të forcojë kontrollin përkatës ligjor të importit, ndërsa inspektorët e tregut të sigurojnë ekspozimin e tyre korrekt, të ndarë në vende të posaçme dhe jo në vende të përziera me produkte të qumështit.
3. Asociacionet e biznesit dhe të konsumatorëve, në bashkëpunim me mediet, të zhvillojnë fushatë vetëdijsimi për përparësitë e konsumit të qumështit të freskët, në krahasim me atë UHT apo të pasterizuar.
4. Rekomandohet që të sigurohen informata përkatëse, lidhur më çmimin importues, përkatësisht me bazën e doganimit të produkteve të qumështit, si dhe të rregullohet me dispozita ligjore apo akte nënligjore evitimi i importeve të produkteve me afat të shkurtër para skadimit të afatit të përdorimit. Gjithashtu, prodhuesit vendorë dhe asociacionet e tyre, duhet të prezantojnë me kohë dokumentacionin dhe provat kur konsiderojnë se ka raste të dampingut në çmime nga importuesit.
5. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, duhet të sigurojnë statistikat e sakta mbi prodhimin vendor dhe importin e qumështit dhe produkteve të qumështit.
6. I rekomandohet Qeverisë, përkatësisht Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, që të bëjë një raport vlerësimi lidhur me efektet e politikave të subvencionimit të prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit, me qëllim të arritjes së efekteve më të mëdha, si dhe ta informojnë Kuvendin lidhur me këtë raport.
7. Të analizohen kushtet higjienike të shtitjes së qumështit në tregun e gjelbër dhe të stimulohet ndërlidhja e këtyre prodhuesve të vegjël, me industrinë e qumështit, si dhe kalimi fermerëve të vegjël në zonën e formalitetit.
8. Rekomandohet që asociacionet e biznesit në këtë sektor, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë

dhe faktorë të tjerë, të hartojnë dhe të zbatojnë një program masash për rritjen e aftësisë konkurruese të këtij sektori, për përmirësimin e cilësisë së produkteve, avancimin e marketingut dhe dizajnit të produkteve të këtij sektori. Këtu duhet analizuar edhe ndikimin e mënyrës së përlllogaritjes së TVSH-së tek prodhuesit fermerë të qumështit.

9. Dogana e Kosovës dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, të ngritin shkallën e performancës dhe të sigurojnë informata më të sakta për sasinë dhe për cilësinë e mallrave të importuara.
10. I rekomandohet Qeverisë inicimin e plotësim-ndryshimit të Ligjit për prokurimin publik, në atë mënyrë që ofertuesve me prodhime vendore, t'i jepet përparësi në proceset tenderuese, në kushte të njëjta.
11. Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, do të përcjellë zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe do të informojë Kuvendin në një periudhë 6 (gjashtë) mujore mbi aktivitetet dhe rezultatet e zbatimit të tyre.

4. Çështjet vijuese me prioritet në Planin e punës së Komisionit

Kryetari, tha se deri më tani kemi një realizim të kënaqshëm të zbatimit të Planit të punës së Komisionit, kryesisht aktivitetet janë realizuar në tërësi sipas kohës së paraparë me planin për vitin 2015. Por, ende kanë mbetur disa vizita pa u realizuar në agjencitë e pavarura dhe ndërmarrje publike. Po ashtu, tha se nuk është realizuar një tryezë e paraparë për agjencitë e pavarura dhe tha se do të angazhohemi ta organizojmë kah fundi i tetorit apo fillimi i nëntorit dhe këtu mund të na ndihmojë edhe Instituti INDEP. Të gjitha të tjerat që varen nga Komisioni, janë kryer. Po ashtu, në kuadër të tyre kemi zhvilluar aktivitetet të tjera, siç është vizita në Shoqatën e Prodhuesve të Qumështit dhe kemi diskutuar në mbledhje, gjë që nuk ka qenë e paraparë në Planin e punës për këtë vit, por është realizuar dhe janë nxjerrë rekomandime. Gjithashtu, edhe për kontestet biznesore dhe adresimin e tyre në gjykata, kemi nxjerrë rekomandime. Për muajt në vijim, që kanë mbetur për këtë vit, propozoi që të ftohen përfaqësuesit e Agjencisë Kosovare të Statistikave, të japin të dhëna për prodhimin vendor në përgjithësi dhe sipas sektorëve.

Fatmir Rexhepi, propozoi që të kërkohet informatë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik për Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, pse ende nuk është propozuar për Kuvend ky Bord. Po ashtu, edhe për Projektligjin për Trepçën, kërkohet informatë se a është hartuar drafti dhe ku ka mbetur çështja lidhur me këtë projektligj, andaj për këto dy çështje kërkoi me urgjencë që të ketë informata, pra se ku ka mbetur çështja.

Kryetari, tha se gjatë këtyre muajve, e kemi paraparë në Planin e punës që t'i ftojmë për raportim tre ministrat e linjës, si: ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, ministrin e Zhvillimit Ekonomik dhe ministrin e Infrastrukturës, për të na njoftuar lidhur me realizimin e planit për këtë vit dhe planifikimet buxhetore për vitin e ardhshëm. Pra, pastaj mund të informohemi për gjitha këto çështje të ngritura. Propozoi që vizita që është paraparë në zonat ekonomike, të kalojë për vitin e ardhshëm, pra në vitin 2016. Ai shtoi se Raporti i performancës së ndërmarrjeve publike, ende nuk është dorëzuar dhe tha se duhet t'i bëhet një njoftim Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, që ta sjellë Raportin e performancës së ndërmarrjeve publike.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Miratohet Plani i punës së Komisionit për vitin 2015 me propozimet e deputetëve.

5. Të ndryshme Çështjet
vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa